



Komuna Malishevë
Zyra për Barazi Gjinore

BULETIN INFORMUES



Malishevë, 2024



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës
Zyra për Barazi Gjinore

Buletin Informues

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Realizimi i Punetorisë - Java e Barazise Gjinore.....	5
Realizimi i Punetorisë - Java e Barazise Gjinore.....	6
Ndarja e mirënjohjeve ** Të drejtat e grave nga mardhënja e punës.....	7
KBGJ-Akterët e Mekanizmit ** Ligjërata - Të drejtat e fëmijëve.....	8
Takim me mësimdhënës ** Aktivitete - Një Qershori.....	9
Takim me OJQ.....	10
Takim-Hartimi i Strategjisë.....	11
Konsultim Publik ** Strategjia Komunale dhe Plani i Veprimit.....	12
Tetori-Muaji i Ndërgjegjësimit ** Nëntori - 16 Ditët e Aktivizmit.....	13
Përmbyllja aktiviteteve 16 Ditët e Aktivizmit ** Debat - dhuna në Familje.....	14
Takim Konsultativ ** Partners Kosova.....	15
Ligjërata - Bullizimi.....	16
Gratë në vendimmarrje.....	17
Fuqizimi i Rinisë dhe Barazia Gjinore ** Implementimi i Strategjisë.....	18
Roli i Grave Parlamentare në dy Nivelet (Lokal dhe Qendror) ** Proceset standarde të veprimit.....	19
Aktivitetet me Handikos ** Bashkë Kundër kancerit të Gjirit.....	20
Kundër trafikimit me qenje njerëzore.....	21
Dita Nderkombetare për PAK.....	22
16 - Ditët e Aktivizmit.....	23
Bashkëpunimet e ZBGJ.....	24
T'i njohim të drejtat tona ** Sensibilizimi i programit në Bujqësi **Vizitë Shoqatës "Fatjona"	25
Java e Edukimit për Barazi Gjinore ** Foto Java e Edukimit për Barazi Gjinore.....	26
Foto - Java e Edukimit për barazi Gjinore.....	27
Edukimi i grave të reja për feminizmin ** Të drejtat e Grave në punë dhe ltegrimi gjinor.....	28
Barazia Gjinore dhe Mbrojtja nga Diskriminimi ** Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje.....	29
E drejta nga mardhënja e punës ** Fuqizimi i Grave drejt Barazisë Gjinore.....	30
Diskutim-projekt-Ligji-shëndeti mendor ** Takim informues-ekipa për të drejtat e fëmijëve**Ligjerata shëndetësore.....	31
Sfidat në proceset e dy niveleve-vendimmarrja ** Takim koordinues ZBGJ-QKMF ** Takim koordinues ZBGJ-KBGJ.....	32
Së bashku do ja dalim-ecje simbolike ** Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve ** Fondi kosovar për garanci kreditore.....	33
Bashkëpunimi ZBGJ-KCSS ** Promovimi i barazisë gjinore ZBGJ-Rrjeti "Qeliza".....	34
Fushata mbrojtja nga trafikimi ** Ligjërata-Konventa e Stambollit.....	35
16-Ditët e Aktivizmit.....	36
Fletëpalosja-Konventa e Stambollit ** Punëtore me nxënës.....	37
Takim përmbyllës-ZBGJ me bashkepunetore ** Bashkëpunimi i ZBGJ-së.....	38

Të dhënat statistikore në baza gjinore.....	39
Të dhënat statistikore në baza gjinore.....	40
Të dhënat statistikore në baza gjinore.....	41
Të dhënat statistikore në baza gjinore.....	42
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	43
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	44
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	45
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	46
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	47
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	48
Mënyra grafike e të dhënave statistikore në baza gjinore.....	49
Feride Hoxha-Drejtoreshë e Handikos.....	50
Fatime Limaj-Shoqata "Fatjona".....	51
Amrush Helshani-Asambleist.....	52
Hidajete Mazreku – Bashkepunetore dhe aktiviste.....	53
Përfundim.....	54
Numrat e telefonit me rëndësi.....	55

Hyrje

Zyra për barazi gjinore në buletin informues ka përmbledhur punën e tri viteve të fundit dhe ka realizuar një sërë aktivitete të cilat kanë qenë të përmbledhura në bazë të planit të punës dhe kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të grave në fusha të ndryshme përmes debateve, fushatave, spotëve promovuese (e drejta në trashëgimi dhe pronë) rekomandimeve, punëtorive dhe bashkëpunimeve ndër-komunale në nivel regional.

Përgjatë debateve janë diskutuar tema të ndryshme, duke filluar nga barazia gjinore në familje, shkollë e shoqëri, e drejta nga mardhënja e punës, integrimi gjinor, komunikimi menaxherial, ngacmimet seksuale, shëndeti e mirëqenja, pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse, pozita aktuale e grave në këto procese, edukimi për feminizmin, sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programet bujqësore, dhuna në familje, mbrojtja nga trafikimi, mbrojtja nga diskriminimi, e kështu me radhë.

Poashtu po vazhdojmë të shprehim përkushtimin ndërinstitucional për të jetësuar edhe më tutje ligjin për barazi gjinore dhe ndikimin për rritjen e bashkëpunimit për qëndrueshmërinë e një shoqërie demokratike, të barabartë dhe pa diskriminim.

Faleminderit

Vera Bytyçi

Zyrtare për Barazi Gjinore

Realizimi i punëtorive përgjatë javës së *edukimit per barazi gjinore*

- Punëtoritë u realizuan me temën barazia gjinore në familje, shkollë e shoqëri, ku nxënësit përmes punimeve dhe eseve kanë paraqitur barazinë gjinore sipas këndvështrimit të tyre, dhe nga juria janë vlerësuar punimet më të mira.
- Poashtu takimi i radhës ka qenë me gratë asambleiste ku është vlerësuar kontributi i gruas ndër vite dhe janë ndarë mirënjohje, me këtë rast në takim in solemn që është organizuar nga zyra për barazi gjinore.



Punëtoritë realizuar me nxënësit me temën “barazia gjinore në familje, shkollë e shoqëri.

Barazia gjinore e shprehur përmes punimeve.



Punëtorja realizuar me nxënës me temën “barazia gjinore në familje, shkollë e shoqëri.

Barazia gjinore e shprehur përmes eseve.



Nxënësit fitues me punimin dhe esenë më të mirë (vlerësuar nga juria)



Ndarja e mirënjohjeve për gratë kontribut-dhënese ndër vite

Janë ndarë mirënjohje për: - kontributin në arsimim,(dy mirënjohje) -shëndetësi, -familje të dëshmorëve, - kontribut të dhënë gjatë luftës, -emancipim, -për të drejtat e grave dhe fëmijëve,-për biznes.



Debati me temën, “të drejtat e grave në mardhënjen e punës në bashkëpunim me Rrjetin “Qeliza” Debati u zhvillua në tri fusha:të drejtat e grave në mardhënjen e punës – në atë institucionalo-publik, sektorin privat dhe social,para së gjithash kishte synim ngritjen e vetëdijësimit dhe informimin për të drejtat para dhe gjatë mardhënjes së punës si dhe u shpalos hulumtimi i bërë lidhur me temën në fjalë.



Takim me KBGJ - akterët e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje
(ku secili prej akterëve shpalosi punën dhe përgjegjësitë në kuadër të mekanizmit).



Ligjërata për të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me këshilltarin e lartë juridik Mark Kaqinari
dhe zëvendës avokaten e popullit Naile Alaj nga institucioni i Avokatit të popullit (me disa grupe të nxënësve)




Ligjërata me mësime në bashkëpunim me këshilltarin e lartë juridik Mark Kaçinari dhe zëvendës avokaten e popullit Naile Alaj (me disa grupe të mësimeve)



Aktivitet me rastin e Një Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve (shpërndarja e fletëpalosjes nëpër shkolla)



-Takim me OJQ-të aktive në komunën e Malishevës – bashkëpunimi mes OJQ-ve, dhe iniciativa që të formohet një organ i përbashkët (rrjetëzimi) i OJQ-ve që punojnë e veprojnë në Malishevë duke vepruar në projekte të përbashkëta, në të mirë të komunitetit.



Takimi i Grupit Punues per Hartimin e Strategjisë Komunale Kundër Dhunës në Familje ndryshimi - plotësimi dhe rekomandimi për Asamblenë Komunale për konsultimin e parë publik .



Konsultimi publik për draft-strategjinë komunale dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje, fillimi, procedurat ligjore, rekomandimet nga ekspertët e fushës për të kaluar më tutje në KPF dhe asamble.



Paraqitja e Strategjisë Komunale dhe planit të veprimit (puna, hartimi, ndryshimet në bazë të rekomandimeve, propozimet) në Asamblenë Komunale dhe miratimi i strategjisë.




TETORI – muaji i ndërgjegjesimit – Mamografia në funksion në QKMF – Malishevë, me stafë të kompletuar, iniciativë e grupit të grave dhe ZBGJ, shërbimet përgjatë muajit tetor ishin pa pagesë dhe mesazhi nga kabineti radiologjik në bazë të njoftimit Tetori Pink ku ftohen të gjitha gratë të kryejnë ekzaminimet, janë kryer gjithësejt 204 echo, dhe 37 mamografi.

NËNTORI – 25 nëntorë, dita ndërkombëtare kundër eliminimit të dhunës ndaj grave, brenda 16 ditëve të aktivizimit duke njoftuar të gjitha shkollat për aktivitete dhe vendosjen e punimeve, mesazheve sensibilizuese, nëpër këndet shkollore dhe mbajtjen e ligjëratave lidhur me temën, u shënuan shumë aktivitete, ku nxënësit kanë paraqitur dhunën dhe parandalimin e dhunës përmes punimeve, eseve dhe mesazheve të ndryshme.



Pas aktiviteteve të shumta përmbyllja e 16 ditëve të aktivizimit u bë me 10 dhjetor, duke shënuar edhe ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut me debatin – bashkëpunimi ndër-institucional kundër dhunës në familje, fillimisht u prezentuan aktivitetet të cilat i kemi realizuar nëpër shkolla për t'u ndërlidhur me debatin, ku përveq akterëve të mekanizmit e pranishme ishte edhe ish drejtoresha e strehimore “shtëpia e sigurt”

Qëllimi i tryezës ishte bashkëpunimi dhe informimi gjithëpërfshirës për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje.



Debat bashkëpunimi ndër-institucional kundër dhunës në familje



Takim konsultativ me përfaqësues të grupit të grave dhe komiteteve (KK dhe KBGJ) lidhur me punën dhe bashkëpunimin për vitin 2022,shqyrtimin e planit të punës dhe realizimin e takimeve të përbashkëta.

Takim konsultativ në bashkëpunim me Partners Kosova me temën “gratë në vendimmarrje për kauza kolektive dhe barazi gjinore”

Realizimi i punëtorisë dy ditore dhe pjesëmarrja në takimin përmbyllës,si dhe shkëmbimi i përvojave me komunën e Podujevës





Ligjëratë për bullizmin në shkolla, nxënësit kanë ndarë përvojat e tyre lidhur me këtë dukuri, dhe kanë përgaditur pjesë të ndryshme për të prezantuar para të pranishmëve, kjo ligjëratë është realizuar në bashkëpunim me policinë dhe janë përfshirë edhe nëntë shkolla tjera.



Takim me asambleistet me temën “gratë në vendimarrje” puna,sfidat dhe barazia gjinore si çështje në asamblenë komunale,pjesëmarrës edhe përfaqësues të OSBE-së



Në bashkëpunim me drejtorinë për kulturë rini e sport,përkatësisht zyrtarin për rini realizuam debatin, “fuqizimi i rinisë dhe barazia gjinore” i ftuar Këshilltari Ligjor në Zyrën e Avokatit të Popullit, Mark Kaqinari i cili foli për rolin e Zyrës së Avokatit të Popullit, Ligjin Nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, barazinë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtat e njeriut. Të rinjtë pjesëmarrës në debat parashtruan pyetje të ndryshme për të cilat morën përgjigje nga Zyrtari Ligjor në Zyrën e Avokatit të Popullit.



Takimi i grupit për implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër dhunës në familje,të pranishëm përfaqësues të grupit punues dhe akterë të mekanizmit,të ftuar edhe zyrtarë nga OSBE - j



Në bashkëpunim me OSBE u mbajt tryeza me temë "Roli i grupit parlamentar i grave lokale në avancimin e barazisë gjinore në Komunën e Malishevës"

Pas diskutimeve me grupin e grave, bashkëpunëtore dhe OJQ-të aktive në komunën e Malishevës, njëherit u zgjodh edhe kryesuesja dhe zëvendës kryesuesja e grupit jo formal të grave.



Në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore pranë zyrës së kryeministrit u realizua trajnimi me temën. Procedurat Standarde të Veprimit Kundër Dhunës në Familje. Të pranishëm në këtë takim për diskutim ishin pjesarë të policisë së Kosovës nga Komuna e Malishevës, anëtarë të grupit punues dhe disa nga akterët e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje. Trajnimi është pjesë e planit të veprimit kundër dhunës në familje, aktiviteti është në kuadër të strategjisë komunale kundër dhunës në familje.



Bashkëpunimi me Hendikos-in vazhdon, ku zhvilloam një mori aktivitete rekreative dhe sociale, me femijët me nevoja të veçanta ku pjesë e aktiviteteve ishin edhe prindërit. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte zhvillimi, integrimi dhe socializimi i fëmijëve në jetën shoqërore dhe të përditshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në integrimin dhe barazinë e të gjithë fëmijëve në jetën shoqërore, dhe sociale.



Bashkë kundër kancerit të gjirit

"Tetori Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit" QKMF "Dr.Shpëtim Robaj" do të ofroj shërbime falas për pacientët. Aktiviteti u realizua në shenjë të muajit tetor, muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, ku gratë ndanë edhe përvojat e tyre për përballjen me kancerin e gjirit, në fund të pranishmëve ju shpërnda edhe fletpalosja e përgaditur nga ZBGJ.

Hapja e fushatës kundër trafikimit me qenje njerëzore,filloi dhe u realizua në bashkëpunim me të gjitha shkollat dhe mësimdhënësit e edukatës qytetare.


“TRAFIKIMI PREKË TË GJITHË, TA MBROJMË VETEN DHE FËMIJËT TANË”.

MOS HESHT




Të gjithë jemi me të drejta të barabarta! Të gjithë jemi me nevoja ndryshe !

3 Dhjetor është Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar,u përshkrua me një sërë aktivitete në bashkpunim me nxënës dhe mësuesdhënës.



Gjashtëmbëdhjetë ditë të aktivizimit kundër dhunës gjinore

Në kuadër të Gjashtëmbëdhjetë Ditëve të Aktivizimit Kundër Dhunës në koordinim edhe me komitetin për Barazi Gjinore, policinë dhe institucione të tjera publike si dhe shoqërinë civile, realizuam aktivitetet për vetëdijësimin që të pengohet fenomeni i dhunës. Është punuar edhe një fletëpalosje me pjesë nga konventa e Stambollit e cila shpalojë të gjitha format e mbrojtëses së grave nga dhuna, poashtu aktivitetet i vazhduam duke përfshirë në bashkëpunim edhe të gjitha shkollat dhe mesimdhësit e edukatës qytetare. Të gjitha aktivitetet janë përcjellur me mesazhin "AS EDHE NJË MË SHUMË"



Ligjërata me temë:
"DHUNA NË FAMILJE"



- ❖ MOS HESHT
- ❖ RAPORTO
- ❖ AS EDHE NJË MË SHUMË
- ❖ MBROJ VETEN DHE TË TJERËT
- ❖ SHPËTO JETË





Takim konsultativ me komitetin për komunitete (aktivitetet e përbashkëta) Disa nga bashkëpunimet



Partners Kosova



Takimi i parë i realizuar në bashkpunim, me temën “*t’i njohim të drejtat tona*”ku u diskutua për ligjin për barazi gjinore dhe të drejtën e pronës



Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programet në bujqësi,strategjia zhvillimore për ofrimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për përmiresimin e mirëqenjes socio-ekonomike dhe për të qenë pjesë e aplikimit në thirrjet publike në nivel komunal dhe qendror të cilat ndikojnë në rritjen e bizneseve të grave (të pranishëm kryetari i komunës dhe drejtori i bujqësisë).



Vizitë shoqatës “*Fatjona*” e cila merret me kultivimin dhe konzervimin e perimeve dhe ju ofron mundësinë grave për punësim sezonal të cilat punojnë deri në përfundim të sezonës.

Java e Edukimit për Barazi Gjinore, është realizuar me disa aktivitete, fillimisht është hapur zyrtarisht java e edukimit për barazi gjinore nëpër të gjitha shkollat, ku janë realizuar ligjërata me nxënës në mënyrë që të përfitohen njohuri lidhur me historikun e të drejtave të grave dhe barazinë gjinore në përgjithësi, me ç'rast nxënësit kanë pasë mundësi ndër të tjera ta paraqesin barazinë gjinore përmes punimeve dhe eseve në bashkëpunim me mësimdhënësit e edukatës qytetare, pastaj janë përzgjedhur punimi dhe esija më e mirë dhe janë ndarë mirënjohje për tri vendet e para.


Nxënësit me punimet e tyre janë paraqitur në takimin solemn me rastin e ndarjes së mirënjohjeve për gratë kontributdhënëse, ku është vlerësuar e drejta dhe roli i gruas në shoqëri dhe i kanë prezentuar punimet e tyre para të pranishmëve.

Ndër të tjera janë vizituar edhe disa nga institucionet të cilat kanë bashkëpunim dhe ndërlidhen me zyrën për barazi gjinore, poashtu janë vizituar edhe organizatat jo qeveritare të cilat janë aktive në komunën tonë, me të cilat është diskutuar për të drejtat e grave dhe rolin e tyre në shoqëri, familje dhe vendimmarrje.

Poashtu muaji mars u përshkrua edhe me hapjen e nëntë bizneseve nga “PredaPlus” (nëntë gra përfituese) dhe u diskutua për renovimin e një qendre për angazhimin e komunitetit ku gratë do të kenë mundësi të realizojnë aktivitete dhe të promovojnë bizneset e tyre.

Ndarja e mirënjohjeve është finalizuar me përmbylljen e ***javës së edukimit për barazi gjinore***, ku janë ndarë mirënjohje për gratë kontributdhënëse ndër vite, mirënjohje: për familje të dëshmorëve, arsim, shëndetësi dhe biznes.

Disa foto nga aktivitetet e realizuara përgjatë “javës së edukimit për barazi gjinore”





Në bashkëpunim me “Artpolis”u mbajt trajnimi “*edukimi i grave të reja mbi feminizmin*”u diskutua për përmiresimin e qeverisjes dhe menaxhimin e përgjithshëm të cilat do të kenë ndikim pozitiv në shoqërinë tonë,duke përfshirë të drejtat e qytetarëve,të drejtën në punë,në pronë,pagë dhe pozita të njëjta,të pranishmit u paisën edhe me çertifikata



Punëtorja me mësimdhënëse“*të drejtat e grave në punë dhe integrimi gjinor*”u diskutua për të drejtat nga mardhënja e punës,komunikimi menaxherial dhe ndër të tjera u diskutua edhe për ngacmimet seksuale në vendin e punës, më tutje u vlerësua se ende është e nevojshme shoqëria jonë për vetëdijësim dhe sensibilizim në shumë fus



Diskutim me mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës lidhur me të drejtat e njeriut, institucionin e avokatit të popullit, **barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi**, funksionimi i kutive të ankesave, njëherit si problem poashtu u diskutua edhe migrimi si pjesë e shqetësimit të mësimdhënësve, ku numri i nxënësve është në rënje dhe poashtu edhe mësimdhënësit rrezikohen për vende të punës.

Në këtë bashkëbisedim u shtjelluan problematika të ndryshme, është realizuar në bashkëpunim me zyrtarin ligjor **nga zyra e avokatit të popullit**, poashtu me të njëjtat diskutime u ndërlidhëm edhe në Gjimnazin “Hamdi Berisha me nxënës dhe mësimdhënës.



Takim me disa prej akterëve të mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje, u diskutua për parandalimin, numrin e rasteve të dhunës, fushatat vetëdijësuese të cilat ndikojnë në parandalim, dhe zgjidhjen e banimit për disa viktime të dhunës (në ndertesën e banimit social disa familje janë vendosur me banim të përhershëm dhe një me banim të përkohshëm) Poashtu u diskutua edhe për bashkëpunimin ndër-institucional i cili është i një rëndësie të veçantë dhe që ndikon në shumë raste edhe në parandalimin e dhunës në familje, dhe u nxoren disa rekomandime të cilat u përcjellën për në zyrën e kryetarit.



Debat me temën *“e drejta nga mardhënja e punës”* me të reja, studente dhe vullnetare nga qendra rinore në bashkëpunim me *“Rrjetin Qeliza”*

Diskutimet ishin të përqëndruara rreth punësimit, aplikimit, ankesat, nënshkrimi i kontratës së punës, diskriminimi në vendin e punës.



Debat lidhur me *“fuqizimin e grave drejt barazisë”* diskutime për të drejtat e grave, trajtimi i çështjeve thelbësore dhe zgjidhja për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë.

Angazhimi i përbashkët sjell ndryshime dhe siguri fillimisht në familje dhe më pas edhe në shoqëri. (bashkëpunimi ZBGJ-Rrjeti “Qeliza”)



Diskutim: **Projektligji për Shëndet Mendor** – në bashkëpunim me “**Qendra për informim dhe përmirësim social**” u diskutua për projektligjin e ri për shëndetin mendor, me fokus të veçantë në përmirësimin e qasjes, cilësisë dhe barazisë në shërbimet e shëndetit mendor.

U dhanë komente dhe rekomandime të ndryshme nga pjesëmarrësit dhe prindërit të cilët ballafaqohen çdo ditë me fëmijët e tyre dhe nuk kanë ndonjë përkrahje nga institucionet.

Takim informues me ekipën për të drejtat e fëmijëve, u diskutua për përvoja të mira dhe dokumente të cilat rregullojnë këtë fushë e cila ndërlikohet me edukim, arsimim, të drejta të barabarta dhe përgjithësisht kundër dukurive negative të cilat sjellin pabarazi, njëherit vetëdijësim dhe sensibilizim në fusha të caktuara.



Në bashkëpunim me “**advancing together**” realizuam ligjëratën shëndetësore me gratë nga zonat rurale lidhur me sëmundjet e ndryshme, por në fokus të veçantë, sëmundja e astmës, shkaqet dhe pasojat.

Tryezë e rumbullakët me temën:”*sfidat në proceset e dy niveleve të vendimmarrjes së gruas sot*” diskutimet u ndërlidhen me pozitën e grave sot,proceset vendimmarrëse,rrugëtimi,sfidat,eksperiencat e grave në vendimmarrje,zbraztirat ligjore,barazia dhe e drejta e pronësise për të dy bashkëshortët.



ZBGJ me bashkëpunëtore ka mbajtur takimin koordinues me QKMF për realizimin e disa aktiviteteve lidhur me muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit,qëllimi i takimit ishte që të vazhdojmë me mamografi funksionale,kontrolla të vazhdueshme,ligjërata vetëdijësuese dhe marsh në mbështetje të grave me kancer gjiri.

Poashtu në koordinim me Komitetin për Barazi Gjinore u koordinuam lidhur me aktivitetet e përbashkëta përgjatë muajit tetor,nëntor, dhe ndër të tjera u diskutua edhe për subvencionet në bujqësi dhe përkrahjen e grave fermere,për mbështetje dhe promovimin e produkteve të tyre përmes panairove të ndryshme (përkrahur nga komuna morën pjesë tri gra fermere në panairin organizuar nga AGROKOS)





Me moton “Së bashku do ja dalim” filluam marshin me ecje simbolike për t’u solidarizuar me të prekurit nga kjo sëmundje, njëherit kjo ecje u realizua për të ndeëgjegjësuar të gjithë qytetarët për kontrollat të vazhdueshme dhe zbulimin e hershëm, ku nëpërmes kësaj shpëtohen jetë. Marshit ju bashkangjiten qytetarë, zyrtarë nga institucione të ndryshme, nxënës nga shkollat e mesme.



Promovimi i spotit **regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve** për dy muaj në TV-lokale, TV-Malisheva (spoti i siguruar nga agjencia për barazi gjinore)



Në bashkpunim me fondin *kosovar për garanci kreditore* realizuam punëtorinë dy ditore me gratë në biznes, për avancimin e njohurive financiare, me ç’rast të pranishmet patën mundësin të fitojnë njohuri lidhur me menaxhimin e bizneseve të tyre



Në kuadër të projektit Gratë, Paqja dhe Siguria, u mbajt takim joformal mes grave të komunitetit dhe institucioneve komunale në Komunën e Malishevës, në bashkëpunim me KCSS

Qëllimi kryesor ishte informimi i grave mbi punën e Mekanizmit Lokal Koordinues kundër Dhunës në Familje dhe angazhimi i Komunës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në baza gjinore.

Pjesëmarrja e përfaqësuesëve të Policisë, Qendrës për Punë Sociale, Agjensisë për Ndhimë Juridike Falas dhe shoqërisë civile shërbeu për të diskutuar mënyrat e koordinimit dhe shkëmbimit të informacioneve në luftën kundër dhunës në baza gjinore. U theksua mungesa e stafit dhe punëtorëve socialë dhe psikologëve në Qendrën për Punë Sociale, duke identifikuar kështu një nga sfidat kryesore në ofrimin e shërbimeve për të gjitha kategoritë sociale. Gjithashtu, u diskutua për problemet e buxhetit komunal për keto çështje, mungesa e qendrave të rehabilitimit dhe strehimores komunale duke theksuar se këto janë çështje të rëndësishme për t'u adresuar në të ardhmen.



Në bashkëpunim me " *rrjetin qeliza* " realizuam debatin lidhur me promovimin e *barazisë gjinore* me pjesëmarrje të kryetarëve të fshatrave, nxënësve dhe drejtorëve të shkollave.

U ndanë përvoja lidhur me të drejtat e grave nga familja, shoqëria e drejta e pronës dhe mardhënja e punës



Në kuadër të fushatës nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore, kemi realizuar takimin koordinues me njohës të kësaj fushe dhe kemi mbajtur ligjërata në tri shkolla të mesme dhe një takim në bashkëpunim me ekipet vepruese për siguri në bashkësi.



Me nxënës të dy shkollave të mesme, dy grupe ndanë përvojat e tyre lidhur me dhunën në familje, sa ata kanë njohuri, a kanë qenë të përfshirë në raste të caktuara në familje ose më gjerë, diskutim për Konventën e Stambollit dhe shpërndarjen e fletëpalosjes me pjesë nga kjo konventë.

16 – Ditët e Aktivizmit Kundër Eliminimit të Dhunës ndaj Gruas



Takim koordinues për aktivitetet në 16 –ditëshin e aktivizmit me zyrtarë nga qendra për punë sociale,njëherit edhe hapja zyrtare, ku u diskutua për punën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen në raste të caktuara të dhunës në familje,poashtu me kushtet,mundësitë,ndihmën,strehimin dhe përkrahjen institucionale.



Takim me kryetarin e komunës dhe zyrtarë nga QPS lidhur me punën sa më efikase dhe në shërbim të qytetarëve. Poashtu edhe rekomandimet të cilat shërbejnë në përmiresimin e shërbimeve dhe të cilat përmirësojnë jetën socio-ekonomike të shumë qytetarëve,në raste të dhunës në familje,fëmijëve të braktisur dhe familjeve strehuese.



Ligjëratë me nxënës të shkollave të mesme lidhur me ***dhunën në baza gjinore,definimin e dhunës,faktorët që shkaktajnë shfaqjen e dhunës në bazë gjinore dhe institucionet që merren me rastet e dhunës në bazë gjinore.*** Qëllimi kryesor për t'u arritur ishte rritja e ndërgjegjësimit tek te rinjët dhe rritja e aktivizmit të tyre që të denoncojnë çdo lloj dhune pranë institucioneve përkatëse.



Viti i dytë - bëhet shpërndarja e fletëpalosjes me pjesë nga **Konventa e Stambollit**, përgaditur nga ZBGJ. Poashtu në të gjitha shkollat është shpërndarë edhe Informatori për staf shkollor rreth zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e njohur si Konventa e Stambollit, si bazë për mësimdhënësit e edukatës qytetare në realizimin e një ore mësimore lidhur me temën në fjalë.



Punëtori me nxënës të shkollave të mesme, fillimisht është diskutuar lidhur me barazinë gjinore në shkollë e familje, dhunën në familje, për t'u ndërlidhur më pas me diskriminimin i cili bëhet në shkollë me raste të caktuara, nxënësit kanë ndarë përvojat e tyre dhe mënyra se si ju kanë qas problemeve e deri te kutitë e ankesave.

Më pas ata kanë bërë disa punime ku kanë paraqitur edhe zanafillën e problemeve të cilat si pasojë sjellin edhe dhunën në familje si dukuri negative dhe shumë e shpeshtë në shoqërinë tonë.



ZBGJ me bashkëpunëtoresh në takimin e fundit për vitin 2023 i cili shënon edhe përmbylljen e aktiviteteve të 16 – ditëshit të aktivizimit, diskutime nga më të ndryshmet dhe planifikimi për aktivitete e fushata të cilat promovojnë barazinë gjinore në vazhdimësi, fushata e kampanja kundër dukurive negative, gratë në proceset vendimmarrëse, e drejta e pronës .

Bashkëpunimi i ZBGJ

Janë mbajtur dy trajnime me organiztën HELP, shoqatat dhe gratë në biznes kanë patur mundësi të ndjekin sesionet se si shkruhet një projekt dhe si mund të plotësohet një aplikacion.

Janë mbajtur 15 ligjërata (Policia e Kosovës) nëntë për bullizmin nëpër shkolla, dy kundër dhunës në familje, në kuadër të ligjërates është bërë edhe shpërndarja e fletëpalosjeve, dhe katër ligjërata për ndërgjegjësimin rreth pronës publike.

Debat – e drejta e trashëgimisë (shoqata Fatjona)

Trajnim artizanal – punime dore (shoqata Fatjona)

GLV – trajnim me nxënës për rastet emergjente (termetet-fatëkeqesitë natyrore) dhe ekspozita përfshirë të gjitha shkollat me temën trashëgimia kulturore.

Të dhënat statistikore në baza gjinore për vitin 2021

Komuna e Malishevës ka gjithësejtë 69.656 banorë me numër të përgjithshëm, 27.973 femra dhe 26.683 meshkuj dhe me 15.000 banorë jo rezident.

Prej 41 shkollave amë dhe dy paraleleve kemi 10 drejtoresha

Janë të regjistruara gjithësejtë 176 biznese – 35 femra –

141- meshkuj Në banimin social kanë përfituar 13

familje (gra kryefamiljare)

Institucioni	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
Komuna	176	30	146	17 %
Arsimi	863	387	476	44 %
Shëndetësia	120	59	61	49 %
	1227	434	793	35 %

	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja
A.Komunale	31	11	20	35 %

Të dhënat statistikore në baza gjinore për vitin 2022

Komuna e Malishevës ka gjithësejtë 69.656 banorë me numër të përgjithshëm, 27.973 femra dhe 26.683 meshkuj dhe me 15.000 banorë jo rezident.

Prej 41 shkollave amë dhe dy paraleleve kemi 10 drejtoresha

Janë të regjistruara gjithësejtë 138 biznese – 22 femra – 116- meshkuj

	Nr i përgjithshëm	Gra	Burra
Komuna Arsimi Shëndetësi	1332	34.98%	65.2%

Asambleja Komitetet	Nr i përgjithshëm	Gra	Burra	Perqindja
A.komunale	31	11	20	35%
KPF	7	4	3	57%
K.Komunitete	5	3	2	60%
K.Diasporë	5	3	2	60%

KBGJ	5	4	1	80%
K.Bujqësi dhe zhvillim rural	5	1	4	20%
K.Arsim Kulturë Rini Sport	5	2	3	40%
K. Shënd. Mirëqenje Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuar	5	//	5	//
K. për Familje të Dëshmorëve Invalid, Veteran të Luftës së UÇK Martir të Luftës	5	//	5	//
K.Planifikimi Urban Kadastër Mbrojtje të Mjedisit,Turizëm, Monitorim të Projekteve	5	1	4	20%

Të dhënat staitikore në baza gjinore per vitin 2023





Postet drejtuese	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja e femrave
Niveli drejtues	28	4	24	14.28

Institucioni	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja e femrave
Komuna	118	21	97	17.79 %
Arsimi	1033	408	625	39.49 %
Shëndetësia	120	59	61	49.16 %
	1271	488	783	38.33 %




	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja e femrave
A.Komunale	31	11	20	35.48 %
KPF	7	3	4	42.58 %
K.Komunitete	5	2	3	40 %
K.planf.urban	5	1	4	20 %
K. për diasp.	5	3	2	60 %
K.bujq.	5	1	4	20 %
Komiteti për arsim,kulturë,rini dhe sport	5	3	2	60 %
K.shëndetësi	5	0	5	0
K.fam.deshm.	5	/	5	0
K.B.GJ	5	4	1	80 %
	78	28	50	35.89 %

Bizneset e regjistruara përgjatë 2023	Nr.i përgjithshëm	Femra	Meshkuj	Përqindja e femrave
	172	31	139	18%


Të dhënat statistikore në baza gjinore në mënyrë grafike për vitin 2021



Të dhënat statistikore në baza gjinore në mënyre grafike për vitin 2022




Komiteti për Komunitete




■ burra ■ gra ■ ■

Komiteti për Diasporë




■ burra ■ gra

KBGJ




■ burra ■ gra ■ ■

Komiteti për bujqësi dhe Zhvillim Rural




■ burra ■ gra

Komiteti për shëndetësi, mirëqenje dhe PAK




■ burra ■ gra ■ ■

Komiteti për Kulturë, Rini e Sport




■ burra ■ gra

Komiteti për familje të
Dëshmorëve, veteranëve, UÇK dhe
martirëve



■ burra ■ gra ■ ■


Komiteti per Planifikim
Urban dhe Kadastër



■ burra ■ gra ■ ■


Të dhënat statistikore në baza gjinore në mënyrë grafike për vitin 2023

Postet drejtuese












■ burra ■ gra

Asambleja Komunale




■ burra ■ gra






Komiteti për Shëndetësi




■ burra

Komiteti për Familje të Dëshmorëve




■ burra

KBGJ



■ burra ■ gra

Feride Hoxha – Drejtoreshë në HANDIKOS Malishevë



HANDIKOS – Organizatë jo Qeveritare në Malishevë daton që nga viti 2002, fillimisht me shumë sfida drejt realizimit të qëllimeve të përbashkëta me komunitetin e prindërve për fëmijët e tyre.

Pas shumë përpjekjeve tona duke u përcjellur me aktivitete, njëkohësisht duke u angazhuar drejt përfaqësimit për të drejtat e personave me nevoja të veçanta kemi arritur në rezultate të mira në aspektin e vetedijësimit dhe sensibilizimit të komunitetit në jetën shoqërore dhe sociale. Shërbimet që ofron organizata e jonë e që kryesisht në qendër të vëmendjes janë fëmijet, nuk do të ishin të plotësuar nëse në këtë aspekt most e kishim bashkëpunim të vazhdueshëm me qeverinë komunale si dhe të gjithë sektoret që punojnë në të mirë të qytetarëve të Malishevës në përgjithësi.

Në veçanti duhet cekur bashkëpunimin me vite me zyrën për barazi gjinore e udhëhequr nga zyrtarja Vera Bytyçi, me të cilën vlen për t'u përmendur shumë aktivitete të përbashkëta siç janë tryezat për të drejtat e njeriut, eskursionet dhe vizitat e shumta në vende historike.

Zyra për barazi gjinore rrugëtoi bashkë me organizatën jo qeveritare HANDIKOS edhe në lobimin e avokimin dhe ngritjen e zërit për të drejtat e personave me nevoja të veçanta kudo që ishte e nevojshme dhe e arsyeshme. HANDIKOS vazhdon duke falemnderuar mbështetjen e institucioneve komunale në Malishevë për bashkëpunimin dhe përkrahjen që organizata jonë të mbijetojë edhe më tutje për të ofruar shërbime dhe për të konsideruar se të gjithë jemi të barabartë në secilën sferë të jetës shoqërore, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Fatime Limaj – Shoqata “Fatjona”

Shoqata “Fatjona” merret me mbjelljen, kultivimin e përimeve dhe më pas edhe konservimin e tyre, të cilat dalin në treg dhe në panairë të ndryshme në tërë Kosovën

Përveç mbjelljes dhe konservimit shoqata në fjalë merret edhe me ushqime tradicionale, punime dore kombëtare të cilat ekspozohen dhe dalin në treg. Poashtu kjo shoqatë punëson një numër të konsiderueshëm të grave përgjatë sezonës.



Bashkëpunimi me ZBGJ ka filluar qysh në themelimin e kësaj shoqate dhe vazhdon ende duke ju referuar takimeve të përbashkëta ku pjesë e tyre jemi gjithëherë, takime të cilat na shërbejnë në përvoja dhe praktika të ndryshme të jetës shoqërore dhe sociale.

Panairët të cilat mbahen kanë një domethënie të veçantë për arsye se kemi rastin dhe mundësinë t'i promovojmë prodhimet tona para qytetarëve dhe të vlerësohemi për punën, të cilën e realizojmë gjatë tërë vitit. Ne si shoqatë përveç me punën e lartpërmendur organizojmë edhe takime të ndryshme për të drejtat e grave dhe aktivitete e vizita të ndryshme, të cilat ndërlihen me punën tonë të planifikuar.

Planifikojmë që të zgjerojmë punën tonë dhe të kemi sa më shumë mundësi që të punësojmë gratë, të cilat kontribuojnë në familje me punën dhe të arriturat e tyre.

Bashkëpunimin me Zyrën për Barazi Gjinore, vazhdojmë ta kemi falë përkrahjes dhe mbështetjes në shumë aktivitete dhe këshilla përgjatë punës sonë të përditshme.

AMRUSH HELSHANI- Anëtar i Asamblesë Komunale Malishevë

Kryesues i Komitetit për Komunitete -K.Malisheve

Anëtar i Komitetit për Barazi Gjinore Malishevë

Përfaqësimi qytetar në asamble komunale është një pjesë e rëndësishme e demokracisë lokale. Kjo përfshin zgjedhjen e përfaqësuesve nga qytetarët për të përfaqësuar interesat e tyre në nivelin komunal të qeverisjes.

Si përfaqësues i zgjedhur jam për të përfaqësuar interesat e qytetarëve në asamble komunale duke marrë pjesë në debatet, duke votuar për propozimet ligjore dhe vendimet e tjera që kanë ndikim në jetën komunale, të përfaqësojë nevojat dhe shqetësimet e banorëve dhe të punojnë për të zgjidhur çështjet që kanë për të mire jetën e qytetarëve. Kjo përfshin diskutimin e politikave lokale, planifikimin urban dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit.



Bashkëpunimi me zyrën për barazi gjinore është një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve për të promovuar barazinë gjinore dhe të adresojë çështjet e diskriminimit gjinor në nivel lokal, për të nxitur politika dhe masa që promovojnë barazinë gjinore dhe largimin e diskriminimit gjinor.

Si anëtar i Kuvendit Komunal Malisheve kam ngritur çështje gjinore që përfshijnë:


1. Zbatimin e politikave për barazi gjinore duke promovuar barazinë gjinore në fusha të ndryshme si arsimit, punësimi, shëndetësia, dhe të drejtat civile.
2. Mbështetjen dhe promovimin e iniciativave lokale të Zyrës për Barazi Gjinore, të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve aktiviste që punojnë për barazi gjinore dhe eliminimin e diskriminimit.
3. Monitorimin dhe raportimin e progresit, implementimin e politikave për barazi gjinore duke raportuar në kuvend për progresin dhe sfidat përfaqësuese për të adresuar këto çështje në nivel lokal.
4. Edukimin dhe sensibilizimin e publikut për çështjet e barazisë gjinore dhe diskriminimit gjinor duke marrë pjesë në debate publike, punëtori, dhe fushata informimi dhe duke dikutuar çështje të ndryshme!

Për të arritur këto qëllime, bashkëpunimi i ngushtë me zyrën për barazi gjinore dhe zyrtaren e ZBGJ-Malishevë Vera Bytyqi është i nevojshëm për të siguruar që politikat dhe masat e miratuara janë efektive dhe që përputhen me nevojat e komunitetit në çështjet e barazisë gjinore. Duke qenë një zë i barazisë gjinore dhe komunitetit në përgjithësi, mund të kemi një ndikim pozitiv në përmirësimin e kushteve për të gjithë banorët e komunitetit, duke promovuar një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë.

Hidajete Mazreku – Bashkepunetore dhe aktiviste

Si aktiviste dhe ish asambleiste vazhdoj të jem pjesë e punës dhe kontributit në arritjen e barazisë dhe çështjeve gjinore, duke u angazhuar në aktivitete të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin e komunitetit për barazinë gjinore dhe të arriturat e grave në shumë sfera të jetës ku ato punojnë dhe kontribojnë.

Në bashkepunim me zyrën për barazi gjinore vazhdoj të jem pjesë e aktiviteteve të shumta duke përkrahur çdo iniciativë që nderlidhet me të drejtat e grave në përgjithësi, duke marrë pjesë edhe në shumë takime konsultative ku diskutohet për problematika të ndryshme, të cilat poashtu kanë të bëjnë edhe me mirëqenjen e qytetarëve dhe përmirësimin e jetës së tyre sociale.



Vlenë të përmendet ndërgjegjësimi për të eliminuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, si dhe angazhimin institucional dhe të shoqërisë civile në këtë fushë, pastaj duke u nderlidhur edhe me të drejtat e trashëgimisë, përmirësimin e shërbimeve shëndetësore (mamografia në QKMF) fushata e kampanja të ndryshme.

Aktivitetet në vazhdimësi ndërlidhen me të gjitha institucionet duke krijuar të drejta të barabarta për një shoqëri demokratike, për qasje të barabartë në secilën lëmi.

Përfundim.

Zyrtarja për barazi gjinore përgjigjet për punën e saj në Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me agjencinë në fjalë, i cili është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandate të hartojë, zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për Barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore në Kosovë.

Zyrtarja për barazi gjinore do të vazhdojë që përmes aktiviteteve në bazë të planifikimit të punës të veçori për një arsim cilësor, shëndetësi të mirëfilltë, mirëqenie sociale, vendimarrje drejt respektimit të ligjit për barazi gjinore për një shoqëri të barabart dhe demokratike.

Komuna e Malishevës është duke bërë përpjekje dhe aktivitete të cilat shprehin përkushtimin ndërinstitucional për të jetësuar edhe më shumë ligjin për barazi gjinore duke përkrahur në realizimin e aktiviteteve, të cilat pasqyrojnë një qasje më të mirë për realizimin e projekteve që ndikojnë në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Jemi të vetëdijshëm që për të jetësuar ligjin për barazinë gjinore kërkohet shumë punë dhe projekte të cilat duhet të realizohen nga institucionet lokale dhe qendrore. Dhe për të përkrahur këto angazhime bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë i rregulltë dhe me premtime që na garantojnë se barazia gjinore do të jetë në standardet e përfaqësimit demokratik edhe në komunën tonë dhe në vendin tonë.

Projektet e deritanishme të realizuara janë dedikuar për fëmijë, të rinjtë, sensibilizimin e shoqërisë për të drejtat e fëmijëve dhe të njeriut dhe për të drejtat e gruas, bashkëpunimin me avokatin e popullit, Policinë e Kosovës, bashkëpunimin e me shoqërinë civile dhe institucionet lokale, të drejtat për trashëgiminë etj.

Besojmë që projektet e ardhshme do të jenë gjithëherë në funksion të zbatimit të ligjit për barazinë gjinore dhe do të ndikojnë për të arritur vlerat e shoqërisë së mirëfilltë demokratike.

Numrat e telefonit me rëndësi :

- **Policia / 192**
- **Qendra e thirrjeve / 112**
- **Numri i policisë, Malishevë / 029-269-007**
- **Zjarrfikësit / 193**
- **Emergjencia / 045-985-211**

- **Zyra për Informim Publik- Komuna e Malishevës**
E-maili zyrtar i komunës është: komuna.malisheve@rks-gov.net dhe
kkmalisheve@gmail.com-tel: +383 (0)29 269 043

- **Zyrtarja për barazi Gjinore: Vera Bytyçi - 044-407-973**
- **Zyrtarja për mbrojtjen nga Diskriminimi: Vera Bytyçi - 044-407-973**
- **Udhëheqësi/zyrtarja, për Komunitete: Edona Krasniqi - 045-651-526**

